



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 349 Akti

Nr. 277 Vendimi
Tiranë, më 21.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në datën 16.7.2020, ora 9:30, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Niko Rapi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimet e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit edhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Niko Rapi është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 12.11.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.
2. Me vendimin e trupit gjykues të datës 19.11.2019 është vendosur kryesues komisioner Lulzim Hamitaj, si dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e tij.
4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 1.7.2020 trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Niko Rapi, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e tij.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore, ku paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Niko Rapi, në seancë dëgjimore, në datën 16.7.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 16.7.2020, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.
9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, ku paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe në përfundim të saj kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Niko Rapi në seancën e datës 21.7.2020, në të cilën subjekti ishte prezent.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.
12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me

vlerësimin pasuror. Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.¹

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga institucionet ligjzbatuese;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumente shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) denoncimet nga publiku;
- ë) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht.

14. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Niko Rapi, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar nga Komisioni, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklaram të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

15. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht, t'i japë të drejtë subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

A. VLERËSIMI I PASURISË

16. Z. Niko Rapi ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33² të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja, e cila në përfundim ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

17. Mbështetur në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë, si vijon:

1. Tokë bujqësore, marrë me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, në fshatin ***, Njësia Administrative *** e Bashkisë Maliq, sipas dokumentit akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP) me nr. *** regjistri, datë 27.2.1995, në emër të kryefamiljarit Dh.R (babai i subjektit). Sipas këtij akti, familja bujqësore ka marrë 14.400³ m² tokë bujqësore në 6 parcela, në të cilat subjekti ka të

¹Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

²“Procedura e vlerësimit të pasurisë: 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, ‘Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë’, ligjin ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’ si dhe ‘Kodin e Procedurave Administrative’.

³Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 24.10.2016, të Njësies Administrative ***, Bashkia Maliq, norma për frymë në fshatin *** të ish-kooperativës bujqësore ***, ka qenë 3.100 m²/person, aq sa ka marrë si anëtar i familjes në datën 1.8.1991.

drejtën e bashkëpronësisë. Në këtë sipërfaqe janë 14.000 m² tokë bujqësore dhe 400 m² truall nën banesë. Pjesa takuese është 1.510 m², pjesë e pandarë e kësaj pasurie në bashkëpronësi dhe sipërfaqe e mbetur 8.040 m². Subjekti, për këtë pasuri, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2000, familja bujqësore me kryefamiljar Dh.R. dhe anëtarë L.R., M.R dhe Niko Rapi i kanë shitur⁴ blerësit Gj.Sh shtëpinë e truallin dhe disa parcela tokë bujqësore, të gjitha të ndodhura në fshatin ***. Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës disa dokumente⁵.*”

1.1 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2003, si të përfituar nga ligji nr. 7501/1991, në bashkëpronësi.

1.2 ASHK – Drejtoria Vendore Korçë ka konfirmuar⁶ se pasuria është përfituar në emër të shtetasit Dh.R (kryefamiljar i familjes bujqësore), me AMTP-në nr. ***, datë 27.2.1995 (trajtuar me ligjin nr. 7501/1991).

1.3 Sipas certifikatës⁷ së gjendjes familjare të datës 1.8.1991, lëshuar nga Njësia Administrative nr. ***, ***, datë 24.10.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë njëri prej anëtarëve të familjes në 1/6 pjesë takuese.

1.4 Sipas dokumentacionit të administruar konfirmohen të gjitha pasuritë me referencat përkatëse të llojit arë apo truall, me sipërfaqet përkatëse dhe gjithashtu konfirmohet edhe shitja e disave prej tyre me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2000.

1.5 Komisioni, në përfundim të hetimit, nuk kishte dyshime lidhur me këtë pasuri.

2. Automjet tip “Mercedes Benz Classic 200 D” (e shitur⁸ para këtij deklarimi), prodhim i vitit 1993, blerë sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2005.

Vlera 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë është çmimi i paguar shitësit për blerjen e automjetit, sipas kontratës së shitblerjes së automjetit + 301.329 lekë sipas mandatit, datë 22.7.2005, për pagimin e doganës dhe TVSH-në, paguar në fillim nga shitësi dhe mbuluar nga blerësi. Në total, vlera e automjetit është 551.329 (pesëqind e pesëdhjetë e njëmijë e treqind e njëzet e nëntë) lekë. Pjesa takuese: 1/2 pjesë të pandarë në bashkëpronësi me bashkëshorten.

2.1 Burimi për krijimin e kësaj pasurie vjen nga:

- a) pakësim i depozitës bankare të kursimit në “Raiffeisen Bank”, me burim të ardhurat nga paga e dy bashkëshortëve, e cila në datën 31.12.2003 ka qenë në vlerën 312.644 (treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë dhe më 31.12.2004 ka qenë në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë. Në datën 22.8.2005 është pakësuar për blerjen e automjetit me 200.000 (dyqind mijë) lekë, llogari e cila ka mbetur në vijim gjendje në vlerën 520.000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë;
- b) tërheqje e vlerës 337.431 (treqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë nga depozita bankare në “Raiffeisen Bank”, llogari e cila është mbyllur në këtë datë;
- c) një pjesë nga shuma e tërhequr në vlerën 180.000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë me burim *overdraft* në “Raiffeisen Bank”, tërheqje e kryer më 22.8.2005, me nr. reference ***.

2.2 Nga analizimi i dokumentacionit rezulton se ky automjet është blerë nga shtetasi Artan Berishaku, në vlerën 2.400 (dy mijë e katërqind) euro ose 300.000 (treqind mijë) lekë dhe është

⁴Pasurinë nr. *** -746 m²; pasurinë nr. *** - 2.000 m²; pasurinë nr. *** - 2.113 m²; pasurinë nr. *** -513 m²; pasurinë nr. *** -931 m², në total 6.303 m², shitur me çmimin 450.000 lekë, duke mbetur 8.040 m², sipas Certifikatës për vërtetim Pronësie, datë 23.12.2016, për pasurinë me nr. ***, me sip. 564 m², sipas Certifikatës për vërtetim Pronësie, datë 23.12.2016, për pasurinë me nr. ***, me sip. 4.368 m², sipas Certifikatës për vërtetim Pronësie, datë 23.12.2016, për pasurinë me nr. ***, me sip. 3.108 m².

⁵Certifikatë Pronësie nr. ***, datë 23.12.2016, për pasurinë arë me nr. ***, Certifikatë Pronësie nr. ***, datë 23.12.2016, për pasurinë arë me nr. ***, me sip. 3.108 m²; Certifikatë Pronësie nr. ***, datë 23.12.2016, për pasurinë arë me nr. ***, me sip. 564 m², e ndodhur në ***, Korçë; akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP) me nr. *** regjistri, datë 27.2.1995; Kontratë Shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2000; vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga Njësia Administrative ***, Bashkia Maliq; certifikata e përbërjes familjare, datë 24.10.2016, ku konfirmohet se në datën 1.8.1991 familja Rapi ka qenë e përbërë nga shtetasit Dh., L., R., A., Niko dhe M.R. (referojuni Aneksit nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶Referuar informacionit dhe praktikës bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 12.3.2020, në dosjen e Komisionit.

⁷Administruar në praktikën bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 12.3.2020, të ASHK-së Korçë, në dosjen e Komisionit.

⁸Me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2016, me çmimin 200.000 lekë.

zhdoganuar në datën 22.7.2005, me deklaratën nr.***. Mbi këtë vlerë janë aplikuar taksat përkatëse.

2.3 Komisioni hetoi llogaritë e deklaruara si burim krijimi për këtë pasuri, nga momenti i krijimit deri në mbylljen e tyre, si edhe për shuma të tërhequra nga llogaria rrjedhëse dhe nuk i rezultuan problematika.

2.4 Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare të vitit 2005, vit kur është kryer investimi në këtë pasuri, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë shumën e deklaruar prej tij, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare gjatë këtij viti (shihni analizën financiare të detajuar për vitet 2003 – 2016).

2.5 Në përfundim rezulton se veprimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit përputhen me ato që rezultuan gjatë hetimit. Mbetet i dyshimtë fakti se shtetasi A.B e ka blerë automjetin në vlerën 2.400 (dy mijë e katërqind) euro ose 300.000 (treqind mijë) lekë dhe ia ka shitur në një periudhë rreth një muaj subjektit të rivlerësimit me një çmim rreth 50.000 lekë më të ulët se çmimi i blerjes.

3. Apartament banimi 2+1, në Korçë, me sip. 98 m², me nr. pasurie *** +1-3, z. k. ***, ndodhur në Rr. “****”, p. nr. ***, shk. ***, k. ***, ap. *** (sot, Rr. “****”), sipas Certifikatës për vërtetim Pronësie nr. *** seriali, datë 5.9.2013, shoqëruar me hartën treguese. Apartamenti është blerë me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2008, lidhur midis shitësit shoqëria “****” dhe blerësit Niko Rapi, në vlerën 3.800.000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 1/2 pjesë të pandarë në bashkëpronësi bashkëshortore.

3.1 Burim i deklaruar i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar:

- a) shuma 1.000.000 (një milion) lekë e krijuar nga kursimet nga paga dhe të ardhura familjare;
- b) shuma 2.000.000 (dy milionë) lekë, kredi bankare e marrë në BKT, sipas Kontratës së Kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2007, të lidhur me kredimarrësin Niko Rapi;
- c) shuma 800.000 (tetëqind mijë) lekë, me burim nga Kontrata e Huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2008, lidhur me huadhënësin Sh.M (babai i bashkëshortes M.M.).

3.2 Deklaruar shlyerje paraprake e kredisë në BKT, me burim huan në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë marrë shtetasit H.H., referuar Kontratës së Huadhënies nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.9.2011⁹.

3.3 Nga dokumentacioni i administruar rezulton se në datën 15.2.2007 është nënshkruar aktmarrëveshje shitje banese ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., dhe blerësit Niko Rapi, me çmim shitjeje të banesës në vlerën 3.800.000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë.

3.4 Kontrata e Shitblerjes¹⁰ nr. *** rep., nr. *** kol., është formalizuar në datën 3.9.2008, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., Korçë dhe palë blerëse shtetasin Niko Rapi, me të dhënat e përshkruara sipas deklarimit të subjektit në deklaratën *Vetting*.

3.5 UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2020, nuk konfirmon kontratë në emër të subjektit apo familjarëve të tij. Është administruar¹¹ dokumentacioni i dosjes së bashkëshortes së subjektit. Sipas shkresës së datës 11.11.2019, konfirmohet subjekti si titullar i kontratës me nr. 681984 klienti, në adresën e kësaj pasurie, në periudhën 2007 – 2019.

3.6 OSHEE-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2020, konfirmon në emër të z. Niko Rapi disa kontrata furnizimi në instancën Korçë, por pa identifikuar atësinë e shtetasve titullarë të kontratave.

⁹Certifikatë Pronësie nr. *** datë 5.9.2013, për pasurinë apartament me nr. ***+1-4, me sip. 98 m²; Aktmarrëveshje shitje banese datë 15.2.2007, midis palës shitëse shoqërisë “****” dhe palës blerëse shtetasit Niko Rapi; mandatarëkëtimi nr. ***, datë 15.2.2007; mandatarëkëtimi nr. ***, datë 15.2.2007; mandat tërheqje nga “Raiffeisen Bank”, datë 13.2.2007; mandatarëkëtimi nr. ***, datë 17.8.2007; Kontratë Shitblerjeje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2008; Kontratë Huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2008; mandatarëkëtimi nr. ***, datë 18.2.2008; vërtetim datë 24.10.2016 nga “Raiffesien Bank”; nxjerrje llogarie të shtetasit Shaqir Muça nga “Raiffesien Bank”, për periudhën 4.8.2005 – 24.10.2016; kërkesë për transaksion datë 15.3.2007, në BKT; vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016, i lëshuar nga BKT-ja, ku konfirmohet se shtetasi Niko Rapi është financuar me kredi; Kontratë Huadhënieje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.9.2011, me palë huamarrëse shtetasin Niko Rapi dhe palë huadhënëse shtetasin Haki Haxhillari; Deklaratë Noteriale nr. 1608 rep., nr. 1009/1 kol., datë 24.9.2012; vërtetimin nr. 1150 prot., datë 24.10.2016; nxjerrje llogarie e shtetasit H.H., datë 25.10.2016 nga “Tirana Bank” (referojuni Aneksit nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

¹⁰Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹Bashkëngjitur pyetësorit nr. 4, datë 6.11.2019, në dosjen e Komisionit.

Është administruar dokumentacioni¹² i dosjes së bashkëshortes së subjektit. Sipas librezës së vënë në dispozicion dhe shkresës nr. *** prot., datë 8.11.2019 konfirmohet subjekti si titullar i një kontrate në instancën Korçë deri në datën 19.2.2019 dhe, më tej, për shkak të shitjes së kësaj pasurie, fakt i vërtetuar edhe nga hetimi administrativ (trajtuar më poshtë), titullar i kësaj kontrate rezulton të jetë shtetasi A.Z.

3.7 Pagesat¹³ për këtë apartament janë kryer, si vijon:

Data	Shuma e paguar në lekë	Dokumentacioni
15.2.2007	500.000	mandatarkëtim
19.2.2007	500.000	mandatarkëtim
17.3.2007	19.600	mandatarkëtim
15.3.2007	1.980.400	urdhërshirim BKT
18.2.2008	800.000	mandatarkëtimi
Total	3.800.000	

3.8 Në analizë të shumës 1.000.000 (një milion) lekë, të krijuar nga kursimet nga paga dhe të ardhura familjare nga hetimi ka rezultuar se në DPV-në e vitit 2007, subjekti nuk ka deklaruar pagesë të kështit të banesës.

3.8.1 Pagesa e kryer në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë rezulton se e ka burimin nga një depozitë në vitin 2007, në “Raiffeisen Bank”¹⁴, e cila ka konfirmuar se në llogarinë nr. *** të subjektit, është kryer tërheqja e shumës 500.000 (pesëqind mijë) lekë, në datën 13.2.2007. Kjo llogari ka kaluar në vlerë *debitore* 29.978 (njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë (nga përdorimi i *overdraftit*) pas tërheqjes së shumës së mësipërme nga subjekti.

3.8.2 Pagesa tjetër në vlerën prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh në vitin 2007, e ka burimin nga kursimet *cash* të subjektit dhe bashkëshortes, e cila e pyetur nga Komisioni për pagesën e kështit prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh në këtë vit, e ka deklaruar se është kryer nga kursimet e vitit 2006 (pakësimi i gjendjes së kursimeve në këtë vit).

3.8.3 Në analizë të gjendjes së kursimeve *cash* në banesë rezulton se subjekti, në DPV-në e vitit 2006, ka deklaruar vlerën prej 700.000 (shtatëqind mijë) lekësh. Në DPV-në e vitit 2007 subjekti deklaroi shtesë gjendje *cash* në banesë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë. Bashkëshortja e subjektit deklaroi në këtë vit kursime nga paga personale dhe e bashkëshortit në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

3.8.4 Në DPV-në e vitit 2007 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2006 dhe as pagesë të kështit të banesës dhe burimin e saj.

3.8.5 Bashkëshortja, e pyetur gjatë periudhës së hetimit të saj, ka deklaruar se në vlerë absolute gjendja e kursimeve është 200.000 (dyqind mijë) lekë dhe se pagesa e kështit prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh është pakësim i gjendjes *cash* të shumës që ka qenë në fund të vitit 2006.

3.8.6 Mbështetur në deklaratimet e subjektit në DPV-në e vitit 2007, kursimet në këtë vit rezultojnë në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, të cilat në analizën financiare rezultojnë në një situatë *cash* negative prej 405.550 (katërqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekësh, e cila e vë subjektin në pamundësi financiare për të kryer pagesën e kështit prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh.

3.8.7 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimin të shpjegojë lidhur me deklaratimet e tij në DPV-në e vitit 2007, në përputhje me detyrimin sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

¹²Bashkëngjitur pyetësorit nr. 4, datë 6.11.2019, në dosjen e Komisionit.

¹³Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁴Shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2020.

3.8.8 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... pranoj faktin se dhe në deklaratën vjetore të vitit 2007 të plotësuar nga unë si subjekt deklarues nuk është pasqyruar si pakësim, pakësimi i gjendjes cash [me 500.000 (pesëqind mijë) lekë] i shumës që ka qenë në fund të vitin 2006 [700.000 (shtatëqind mijë) lekë]. Megjithatë, në deklaratën vjetore të vitit 2008, është përshkruar fakti që mbulimi i vlerës prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh të çmimit të shitjes (shlyer në shkurt të vitit 2007), është bërë nga ‘kursimet nga viti 2006’ (citim).

...

Në fakt, deklarami në vitin 2007 prej 200.000 (dyqind mijë) lekësh nuk përbën shtesë, sikurse është plotësuar në kolonën përkatëse (ndryshime në interesa, shtesa, pakësime), por është gjendja cash e mbetur nga kursimet e vitit 2006, pas mbulimit të çmimit prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh për shlyerjen e një pjese të çmimit të blerjes së banesës në Korçë, sipas Kontratës së Porosisë datë 15.2.2007 dhe sipas mandatarkëtimit me kompaninë e ndërtimit nr. ***, datë 19.2.2007. Kursime të vitit 2007 nuk ka pasur. Kjo shumë vijon të jetë e njëjta, e mbetur nga kursimi i deklaruar në vitin 2006.”

3.8.9 Në përfundim arrihet në konkluzionin se deklaramet e subjektit në deklaratën *Vetting* nuk përputhen me deklaramet në DPV-në e vitit 2007. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë mundësi financiare që me të ardhurat nga paga të kursejnë shumën e deklaruar në fund të vitit 2006 dhe atë të deklaruar në fund të vitit 2007, por subjekti rezulton me pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme edhe pagesën e shumës prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh, të kryer në datën 19.2.2007. Komisioni, duke mbajtur në konsideratë orientimin e Kolegjit për të mos prezumuar përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë prej tij në deklaratat periodike, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja janë në pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme edhe pagesën në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë të këstit të apartamentit, duke rezultuar me një diferencë negative në shumën 405.550 (katërqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë në vitin 2007. Lidhur me pagesën e këstit në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë me burimin nga të ardhurat në një depozitë në vitin 2007, në “Raiffeisen Bank”, është kryer tërheqja e vlerës prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh, në datën 13.2.2007, Komisioni krijoi bindjen se kjo shumë është përdorur për pagesën e kryer sipas mandatarkëtimit të datës 15.2.2007.

3.9 Në lidhje me pagesën prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh, të mbuluar nga kredia dhe kursimet në vitin 2007, BKT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, ka konfirmuar kredinë e marrë nga shtetasi Niko Rapi, për të cilën është lidhur Kontratë Kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2007. Shuma e kredisë është në vlerën 26.000 (njëzet e gjashtë mijë) CHF (franga zvicerane) me qëllim blerje apartamenti. Për këtë kredi është nënshkruar edhe Kontrata e Hipotekimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2007, ku hipotekues janë shtetasit R. dhe E.R. Kjo kredi është siguruar me pasurinë “apartament me sip. 62.9 m², nr. pasurie ***+2-14, e regjistruar në ZVRPP-në Korçë, me adresë: Rr. “****”, p. ***, sh. ***, k. ***, ap. ***, Korçë”.

Kredia 26.000 (njëzet e gjashtë mijë) CHF është *disbursuar* në datën 15.3.2007 dhe në po të njëjtën datë është transferuar shuma prej 25.455 (njëzet e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) CHF ose 1.980.400 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind) lekë në llogari të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., me përshkrimin “këst për blerje apartamenti”.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka mbyllur kredinë bankare para afatit dhe se i ka marrë si burim për mbylljen e kredisë një hua në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë shtetasit H.H.

3.9.1 Gjatë hetimit nga Komisioni është konstatuar se kredia e marrë në BKT është në monedhën franga zvicerane (CHF), ndërkohë qëllimi i këtij financimi ka qenë pagesa e kësteve për blerjen e apartamentit në Korçë, të cilat kanë qenë në monedhën lekë.

3.9.2 Huaja e marrë shtetasit H.H., konfirmohet me kontratën¹⁵ dhe deklaratën noteriale për shlyerjen e saj, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2012.

3.9.3 Nga korrespondenca e mbajtur me BKT-në¹⁶ vihet re se në datën 14.9.2011 subjekti i rivlerësimit derdh në llogari shumën prej 435.000 (katërqind e tridhjetë e pesë mijë) lekësh, shumë e cila në të njëjtën datë është konvertuar në franga zvicerane për të mbyllur kredinë.

3.9.4 Subjekti është pyetur¹⁷ në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave të huas nga huadhënësi dhe, në përgjigje, ka shpjeguar se: *“Burimi i krijimit të kësaj vlere nga huadhënësi janë të ardhura të siguruara nga paga e tij ndër vite”*. Për këtë, subjekti ka depozituar tri vërtetimet¹⁸ e punësimit të huadhënësit. Nga verifikimi i korrespondencës bankare¹⁹ në tërësi rezulton se huadhënësi ka llogari në disa prej bankave të nivelit të dytë, në monedha të ndryshme, ku, gjithashtu, vihen re lëvizje dhe transaksione me shuma të konsiderueshme prej vitit 2004 e në vazhdim. Nga hetimi i këtyre llogarive nuk ka rezultuar kryerja e ndonjë transaksioni tërheqjeje rreth datës apo vlerës së dhënë hua, nga llogaritë bankare të shtetasit H.H.

3.9.5 Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se huadhënësi ka punuar kryesisht në institucione shtetërore. Të ardhurat e përfituara nga këto punësime, në raport me shpenzimet e jetesës për periudhën e dhënies së huas, duket se janë të mjaftueshme për të justifikuar këtë huadhënie.

3.9.6 Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare për vitet 2011 – 2012, periudhë kur është marrë kjo hua për të mbyllur kredinë, si dhe për kohën që është shlyer. Nga analiza financiare duket se subjekti ka pasur mundësi financiare të shlyejë kredinë në vitin 2011 dhe huan në vitin 2012 (shihni analizën financiare të detajuar për vitet 2003 – 2016).

3.9.7 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit se pse ka marrë një kredi në monedhën franga zvicerane (CHF), ndërkohë që qëllimi i këtij financimi ka qenë pagesa e kësteve për blerjen e apartamentit në Korçë, të cilat kanë qenë në monedhën lekë.

3.9.8 Subjekti ka shpjeguar se: *“Për sa i përket shpjegimit të kërkuar lidhur me marrjen e kredisë në BKT në monedhën franga zvicerane (CHF), ndërkohë qëllimi i këtij financimi ka qenë pagesa e kësteve për blerjen e apartamentit në Korçë, të cilat kanë qenë në monedhën lekë, ju sqaroj se në momentin kur unë do të merrja kredi, franga zvicerane paraqitej me interes.*

Me dokumentacionin e dorëzuar në janar të vitit 2017 në kuadër të procesit Vetting kam depozituar vërtetimin e BKT-së për të gjitha pagesat e kryera gjatë periudhës së kredisë mars 2007- shtator 2011. Këtu del në pah rritja në mënyrë të dukshme e monedhës CHF, e cila ka pasur kurs të ulët në momentin e marrjes së kredisë, rrethanë që ka qenë edhe shkaku i marrjes së kredisë në këtë monedhë ”.

3.9.9 Shpjegimet e subjektit ishin bindëse për Komisionin.

3.10 Në lidhje me shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, të marrë hua nga babai i bashkëshortes së subjektit si burim i krijimit të pasurisë, subjekti deklaron në DPV-në e vitit 2008 hua, me përshkrimin *“të ardhura nga Kontrata e Huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2008, huadhënës Sh.M”*, të cilën subjekti e deklaron edhe si burim për blerjen e pasurisë apartament në Korçë.

3.10.1 Në përgjigjen²⁰ e pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *“Vlera 800.000 (tetëqind mijë lekë) është rezultat i aktivitetit bujqësor të prindërve të bashkëshortes, Sh. dhe S.M., si të vetëpunësuar në bujqësi. Rezulton se familja me kryefamiljar vjehrrin tim është trajtuar me tokë*

¹⁵Aneks nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶Nr. ***prot., datë 13.2.2020, në dosjen e Komisionit.

¹⁷Pyetësori nr. 1, datë 22.12.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁸Për periudhën 20.3.2006 – 6.9.2007 ka ushtruar detyrën e Avokatit të Shtetit, pranë Zyrës Vendore Korçë, me të ardhura neto gjatë kësaj periudhe në shumën prej 1.245.332 lekësh; për periudhën 10.9.2007 – 10.6.2008 pranë Agjencisë së Kihimit dhe Kompensimit të Pronave, me pagë bruto 66.060 lekë dhe me pagë neto 52.096 lekë, të ardhura bruto për këtë periudhë gjithsej në shumën 660.703 lekë, të ardhura neto në shumën 528.198 lekë, sipas vërtetimit nr. *** prot, datë 22.10.2009; për periudhën maj 2009 - gusht 2015 ka qenë i punësuar pranë ish-Komisionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka përfituar të ardhura bruto në shumën 5.400.139 lekë, ndërsa për periudhën maj 2009 – gusht 2011 ka përfituar të ardhura bruto në shumën 1.849.452 lekë. Këto sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 22.10.2019.

¹⁹Referojuni përgjigjeve të bankave mbi kërkesën nr. *** prot., datë 21.11.2019, të Komisionit (referojuni përgjigjeve të bankave mbi kërkesën nr. ***, datë 4.12.2019, të Komisionit).

²⁰Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 19a, në pyetësorin standard datë 1.12.2019, administruar me nr. *** prot., datë 7.1.2020, në dosjen e Komisionit.

*bujqësore, e cila në fakt iu është vënë në përdorim anëtarëve të familjes bujqësore në një kohë më të hershme sesa data e aktit të marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, datë 9.8.1994, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, 'Për tokën', në muajin gusht 1991. Për këtë, ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 22.10.2019, të Njesisë Administrative ***, Bashkia Shijak. Sipërfaqja e tokës me të cilën është trajtuar familja është 10.822 m². Duke shfrytëzuar këto sipërfaqe toke bujqësore, si pasojë e aktivitetit të zhvilluar në bujqësi nga prindërit e mi, shitjes së produkteve bujqësore, janë krijuar në vijimësi të ardhura, mbi të cilat është mundësuar jetesa e familjes dhe kursimi i një pjese të tyre.” Subjekti ka depozituar një sërë dokumentesh²¹ në funksion të përgjigjes së dhënë.*

3.10.2 Nga dokumentacioni i depozituar, më konkretisht në shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2019, të Njesisë Administrative ***, paraqitet një përllogaritje e përafërt e vlerës së produktit bujqësor, që mund të merrej nga sipërfaqet e tokës që janë përdorur si serra (plastmasë), ndër vite. Në të, përshkruhet rendimenti i pritshëm për një dynym perime të kultivuar në serrë, si dhe prodhimi total në vlerën 4.715.040 (katër milionë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë të ardhura në vit.

3.10.3 Nga korrespondenca e mbajtur me bankat e nivelit të dytë, në veçanti me “Raiffeisen Bank”²², rezulton se shtetasi Sh.M ka pasur llogari depozite me datë fillestare raportimi më 12.8.2005, e cila është mbyllur më 4.3.2009.

3.10.4 Nga analiza e dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se në llogaritë e huadhënësit nuk ka pasur tërheqje rreth datës së huadhënies, 14.2.2008, dhe në vijim, në datën 3.3.2008, shtetasi Sh.M ka depozituar duke rritur vlerën e depozitës ekzistuese në “Raiffeisen Bank” me 1.000.000 (një milion) lekë.

3.10.5 Gjithashtu, gjatë hetimit u konstatua se deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit, mbi burimin e ligjshëm të krijimit të huas në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë dhe mundësinë e huadhënësve, nuk janë shteruese sepse nuk janë mbështetur mbi dokumente dhe informacione mbi të ardhurat faktike të huadhënësit, por mbi dokumente dhe informacione të supozuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me qarkullimin e mundshëm nga ky aktivitet nëse situata e prodhimtarisë do të kishte rendiment 100 % dhe përfshi faktin se aktiviteti i përmendur ka edhe shpenzime lidhur me investime të nevojshme. Mbetet e paprovuar se sa kanë qenë fitimet e familjes nga ky aktivitet, nga të cilat duhet zbritur minimumi i shpenzimeve jetike dhe gjendjet në llogaritë bankare të huadhënësve.

3.10.6 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar mbi mundësinë financiare dhe mundësitë reale të krijimit të të ardhurave të huadhënësve nga aktiviteti i deklaruar.

3.10.7 Subjekti ka shpjeguar duke përllogaritur të ardhurat referuar pagës minimale e duke arsyetuar se ato janë të mjaftueshme për të dhënë këtë hua, duke cituar se: “... në raport me këto të ardhura, vlera prej 800.000 (tetëqind mijë) lekësh, që prindërit e mi më kanë dhënë hua në datën 14.2.2008, është vetëm 29.7 %”. Po ashtu, subjekti arsyeton edhe të ardhurat *neto* të realizuara prej prodhimit bujqësor në 7 dynym serrë, duke iu referuar sërish në mënyrë hipotetike të ardhurave të mundshme që familja bujqësore duhet të ketë bazuar në sipërfaqen e tokës që disponon.

3.10.8 Duke marrë në konsideratë dhe jurisprudencën e Kolegjit, Komisioni konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk mund të konsiderohet si dokumentacion i justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, duke mos provuar mundësinë financiare të babait të subjektit

²¹Vërtetim, datë 21.3.2016, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës; vërtetim datë 21.10.2016, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës; vërtetim nr. *** prot., datë 16.8.2016, Njësia Administrative ***, Bashkia Shijak; vërtetimi i Njesisë Administrative ***, Bashkia Shijak nr. *** prot., datë 18.3.2019; vërtetim nr. *** prot., datë 25.3.2019, i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë, MBZHR-ja; certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm, datë 28.3.2019, bashkëngjitur karta e fermerit; Kontratë Shitblerjeje, datë 30.8.1992, shoqëruar me vërtetim nënshkrimi nr. ***; vërtetimi nr.119, datë 18.3.2019, i Njesisë Administrative ***, Bashkia Shijak; vërtetimi nr. *** prot., datë 22.10.2019, i Njesisë Administrative ***, vërtetimi nr. *** prot., datë 22.10.2019, i Njesisë Administrative ***, Bashkia Shijak; vërtetimi nr. ***, datë 19.3.2019, i DRSSH-së Durrës; vërtetimi nr. ***, datë 19.3.2019, i DRSSH-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 10.1.2019, e ZVRPP-së Durrës; kërkesë nr. *** prot., datë 23.10.2019, drejtuar ISSH-së Tiranë; kërkesë datë 30.10.2019, drejtuar IST-së; shkresë nr. *** prot., datë 29.10.2019, e ISSH-së Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2019 e DPP-së Statistikor.

²²Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2020, në dosjen e Komisionit.

për të mbuluar me burime të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhënien e huas në vitin 2008.

3.11 Në lidhje me trajtimin e mundshëm preferencial për vlerën 3.800.000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë, të shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie, nga dosja e bashkëshortes së subjektit është administruar korrespondenca²³ e mbajtur me shoqërinë ndërtimore “****” sh.p.k.

3.11.1 Sipas akteve, kësaj shoqërie i është kërkuar të japë informacion, si dhe të depozitohë dokumentacion shoqëruar mbi pagesat e kryera për këtë pasuri, por edhe të depozitohë kontrata të ngjashme të blerësve të tjerë në të njëjtën godinë dhe në të njëjtën kohë.

3.11.2 Shoqëria²⁴ ka depozituar tri aktmarrëveshje për shitje banese në të njëjtën godinë, përkatësisht me shtetasit G. dhe J.B në datën 29.5.2007, për një sipërfaqe banimi prej 70 m², në shumën 2.800.000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë; me shtetasin Dh.F më 5.7.2007, për një sipërfaqe banimi prej 100 m² (të dhëna që përkohë edhe me të dhënat e pasqyruara në aktmarrëveshjen e nënshkruar me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për këtë pasuri), në vlerën 3.700.000 (tre milionë e shtatëqind mijë) lekë; si dhe me shtetasin B.R në datën 17.2.2007, përsëri për një sip. prej 100 m², në shumën 3.800.000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë.

3.11.3 Në përfundim ka rezultuar se edhe banorë të tjerë kanë blerë pasurinë me të njëjtat çmime referuese, si dhe subjekti i rivlerësimit.

3.12 Në lidhje me ekzistencën e konfliktit të interesit me huadhënësin, shtetasin H.H. Komisioni ka administruar nga dosja e bashkëshortes së subjektit, korrespondencën²⁵ e mbajtur me institucionet punëdhënëse të subjektit dhe të bashkëshortes. Nga informacioni i përcjellë nuk është konfirmuar shqyrtimi i ndonjë procesi gjyqësor në favor të këtij shtetasi.

3.13 Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk ka pasur dyshime lidhur me marrëdhënie të mundshme të konfliktit të interesit apo trajtime preferenciale të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

4. Apartament banimi, me sip. 95.03 m², me strukturë 2+1, ndodhur në Rr. “**”, Tiranë, blerë në gjendje të mobiluar (pasuria me nr. ****+1-12²⁶, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. të brendshme 86 m², me sip. të përbashkët 9.03 m², me sip. të përgjithshme 95.03 m²) dhe garazh (pasuria me nr. ***-G47, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 17.7 m², vendparkimi nr. ***)**, në bashkëpronësi me bashkëshorten M.M, referuar Kontratës së Shitblerjes me Kushte dhe Rezervë për pasurinë e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.9.2015. Vlera: 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë, 9.000.000 (nëntë milionë) lekë apartamenti dhe 1.000.000 (një milion) lekë garazhi. Në këtë çmim është përfshirë edhe gjendja e mobilimit të banesës në momentin e blerjes dhe të dorëzimit fizik. Pjesa takuese: 1/2 e pandarë, në bashkëpronësi bashkëshortore.

4.1 Burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar²⁷:

- a) Kontratë Kredie bankare dhe hipoteke, nr. **** rep., nr. **** kol., datë 17.9.2015, në shumën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, në “Raiffeisen Bank”;
- b) shuma prej 1.000.000 (një milion) lekësh nga kursimet në llogarinë bankare në “Union Bank”;

²³Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 27.11.2019 si dhe dokumentacionit bashkëngjitur.

²⁴Referojuni dokumentacionit bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 27.11.2019.

²⁵Shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresën nr. *** prot., datë 19.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; shkresën nr. *** prot., datë 19.11.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

²⁶Sipas shënimit në seksionin E të kartelës së kësaj pasurie të paluajtshme, bërë në datën 18.9.2015, kjo pasuri është bllokuar në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a., për shlyerjen e shumës 5.000.000 lekë kredi, referuar kontratës së mësipërme datë 17.9.2015.

²⁷Certifikatë Pronësie nr. *** datë 9.9.2015, për apartamentin me nr. ****, z. k. 8330. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese; Certifikatë Pronësie nr. ****, datë 9.9.2015, për garazh me nr. **** z. k. ****; bashkëngjitur dokumentacioni i pronësisë së pronarit të mëparshëm dhe kopje kartash identiteti; kopje kartele e pasurisë nr. ****, nxjerrje llogarie në emër të znj. M.M e printuar me datë 20.10.2016, nga “Union Bank”; urdhër pagesë e brendshme datë 4.9.2015, kryer nga znj. M.M; urdhër pagesë e brendshme datë 7.9.2015, kryer nga znj. M.M; Kontratë Huaje nr. **** rep., nr. **** kol., datë 3.9.2015; Certifikatë regjistrimi e personit të tatueshëm “****” me NIPT *****, njoftim debitimi datë 3.9.2015 i “Raiffeisen Bank”; njoftim debitimi datë 4.9.2015 i “Raiffeisen Bank”; vërtetim datë 18.10.2016 nga subjekti “****” sh.p.k.; ekstrakt historik i shoqërisë “****” sh.p.k., e cila është regjistruar nga viti 1997 me NIPT *****, vërtetim datë 20.1.2017, nga subjekti “****” sh.p.k.; vërtetim datë 20.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”; Kontratë Kredie bankare dhe hipoteke me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 17.9.2015, bashkëngjitur Certifikata e Pronësisë, kopja e kartelës dhe harta treguese e kësaj pasurie dhe aneksi 3 i kontratës lidhur me pagesat që duhet të kryejë klienti (referojuni Aneksit nr. **** në dosjen e ILDKPKI-së).

c) hua në shumën 4.000.000 (katër milionë) lekë sipas Kontratës nr. **** rep., nr. **** kol., datë 3.9.2015, nga shoqëria “*****” sh.p.k., me qendër në Pogradec, regjistruar në QKR me NIPT ****, me administrator z. L.B.

4.2 Pasuria apartament banimi me sip. 95.03 m², me strukturë 2+1, ndodhur në Rr. “*****” Tiranë, është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2015 me përshkrimin “blerje apartament banimi (pasuria nr. *****, me sip. 86 m², me strukturë 2+1, Rr. “*****”, Tiranë, të mobiluar) dhe garazh (pasuria me nr. *****, me sip. 17.7 m², vendparkimi nr. *****). Vlera: 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë. Pjesa takuese: 50 %”, pa deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

4.3 Kjo pasuri konfirmohet me Kontratën e Shitblerjes²⁸ me Kusht dhe Rezervë (pasuri e paluajtshme) nr. **** rep., nr. **** kol., datë 4.9.2015, me palë shitëse shtetasin K.Y dhe palë blerëse shtetasit Niko Rapi dhe M.M. Çmimi i kontratës është në vlerën 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë, ku në këtë vlerë është përfshirë edhe vlera e mobilimit të apartamentit. Vlera e apartamentit është 9.000.000 (nëntë milionë) lekë dhe vlera e garazhit 1.000.000 (një milion) lekë.

4.4 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, konfirmon të regjistruar në emër të shtetasit Niko Dhori Rapi në bashkëpronësi me znj. M.Sh.M, pasuritë: apartament me sip. 86 m², z. k. ****, vol. ****, f. ****; dhe garazh me sip. 17.70 m², z. k. ****, vol. ****, f. ****.

4.5 UKT-ja identifikon një abonent me Kontratë me nr. **** për objektin me adresë Rr. “*****” Tiranë. Kontrata është me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

4.6 OSHEE-ja konfirmon në emër të z. Niko Dh. Rapi një kontratë furnizimi me nr. **** në instancën Tiranë. Komisioni, nga analiza e dokumentacionit të këtij institucioni, konstaton se kjo kontratë është hapur në datën 24.9.2013 dhe se ndryshimi i emrit është kryer më 11.2.2016.

4.7 Në lidhje me burimin e shumës 5.000.000 (pesë milionë) lekë, nga kredia e marrë në “Raiffesen Bank” rezulton e lidhur Kontratë Kredie bankare dhe hipoteke nr. **** rep., nr. **** kol., datë 17.9.2015, në shumën 5.000.000 (pesë milionë) lekë. Qëllimi i kredisë është për blerje apartamenti dhe po ky apartament është vendosur si kolateral. Kredia është *disbursuar* në datën 21.9.2015 dhe po në të njëjtën datë është kaluar me urdhërxhirim bankar në llogarinë e noteres Xh.B, Person Fizik, me përshkrimin: “kalim për blerje shtëpie me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 3.9.2015, pagesë përfundimtare”.

4.8 Në lidhje me shumën 1.000.000 (një milion) lekë kursime në “Union Bank”. Nga korrespondenca e mbajtur me “Union Bank” rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është pagamarrëse në këtë bankë, e cila, në datën 7.5.2014, ka nënshkruar autorizim për pagesë periodike, ku autorizon bankën për debitimin e shumës 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë çdo muaj në llogarinë e saj të kursimeve. Kjo llogari kursimi, deri në datën 4.9.2015, kishte arritur vlerën prej 1.148.203,36 (një milion e njëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e tre e tridhjetë e gjashtë cent) lekë, shumë të cilën bashkëshortja e subjektit e ka transferuar në llogarinë rrjedhëse. Nga këto kursime, në datë 7.9.2015, është paguar me transaksion bankar vlera prej 1.000.000 (një milion) lekësh për blerjen e apartamentit.

4.9 Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor për vitet 2014 – 2015, nga momenti i krijimit të llogarisë së kursimeve dhe investimi në këtë pasuri rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të krijojë kursimet, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

4.10 Në lidhje me huan në shumën 4.000.000 (katër milionë) lekë nga shoqëria “*****” sh.p.k., me qendër në Pogradec, me administrator shtetasin L.B, nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka deklaruar huan në DPV-në e vitit 2015 me përshkrimin “huamarrje nga shoqëria “*****” sh.p.k. (referuar kontratës së huas nr. **** rep., nr. **** kol., datë 3.9.2015), në shumën 4.000.000 lekë”.

²⁸Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

Pjesa takuese: 100 %. Subjekti ka depozituar²⁹ Kontratën e Huas dhe bilancin e vitit 2015 të shoqërisë “*****” sh.p.k., ku pasqyrohet huaja e dhënë.

4.11 Gjatë hetimit ka rezultuar se kjo hua është kaluar me transaksion bankar në datën 3.9.2015 në “Raiffeisen Bank”, nga kjo shoqëri te subjekti i rivlerësimit, me përshkrimin “dhënie huaje për blerje apartamenti”. Në datën 4.9.2015 kjo shumë është kaluar me urdhërxhirim në llogarinë e noteres Xh.B, Person Fizik, me përshkrimin “kalim në bazë të Kontratës së Huas nr. **** rep., **** kol., datë 3.9.2015”. Për ligjërimitin e kësaj huaje, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁰, si dhe ka shpjeguar dhe provuar në pyetësorin standard³¹ mënyrën e shlyerjes së saj (sikurse ishte parashikuar në kontratë) me të ardhurat nga shitja e pasurisë nr. 3, të hetuar dhe të sipërtrajtuar. Subjekti ka deklaruar se: “... *shuma e huas së marrë nga shoqëria ‘*****’ sh.p.k. është shlyer tërësisht në datën 18.2.2019 dhe burimi i krijimit të kësaj vlere është vlere në lekë e çmimit të shitjes së njësisë së banimit/apartamentit të ndodhur në Korçë*”.

Subjekti ka depozituar dokumentacionin³² për shitjen e pasurisë, si dhe për kthimin e huas nëpërmjet sistemit bankar dhe atij noterial.

4.12 Nga aktet e administruara rezulton se pasuria e përshkruar në pikën 3 “apartament banimi 2+1, në qytetin e Korçës”, është shitur me Kontratë Shitblerjeje nr. ****, datë 9.2.2019, në shumën 4.650.000 (katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, shumë e depozituar nga blerësi në datën 15.2.2019, në llogarinë bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank” dhe më tej, po nga kjo llogari me transfertë bankare në datën 18.2.2019, ka kaluar në favor të shoqërisë ndërtimore “*****” sh.p.k., shumë prej 4.000.000 (katër milionë) lekësh, me përshkrimin “kthim huaje”.

4.13 Në përfundim, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë përse një shoqëri tregtare, e krijuar për të nxjerrë fitime nga biznesi, do të ishte e interesuar për t’i dhënë hua shumë prej 4.000.000 (katër milionë) lekësh një personi privat që nuk ka asnjë lidhje me këtë shoqëri, pa llogaritur interesin.

4.14 Subjekti, ndër të tjera, në shpjegimet e tij ka qartësuar se: “... *pavarësisht se huadhënës është një shoqëri tregtare, e cila ka qëllim të saj in nxjerrjen e fitimeve, përpilimi i një Kontrate Huadhënieje pa interes, ka ndodhur sepse vetë administratori i saj L.B dhe dy vëllezërit e tij bashkortakë kanë vlerësuar në atë moment dhënien e kësaj shume nga likuiditetet e shoqërisë dhe jo nga likuiditetet personale. Kjo, meqenëse ende (viti 2015) nuk kishin tërhequr vlerën e dividendit nga shoqëria, dividend i cili, nga interesimi im referuar pyetësorit tuaj, është shpërndarë rreth 160.000.000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekë dhe paguar tatim mbi dividendin në vitin 2019.*

Në lidhje me këtë moment theksoj se marrëdhënia e huas që është krijuar në një moment të caktuar (e që nuk ekziston më), nuk është në përfitim, por thjesht zgjidhje e një problemi të krijuar në një situatë të caktuar për shkak të nevojës nga një mik e një person me njohje më të hershme”.

5. Në lidhje me ekzistencën e konfliktit të interesit, me huadhënësin, z. L.B, Komisioni ka administruar³³ dokumentacionin e marrë nga dosja e bashkëshortes së subjektit.

5.1 Nga korrespondenca e mbajtur me institucionet punëdhënëse të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, nuk është konfirmuar shqyrtimi i ndonjë procesi gjyqësor me palë shoqërinë “*****” sh.p.k., apo me ortakët e kësaj shoqërie, përkatësisht, shtetasit L.B apo ortakët e tjerë shtetasit A. dhe I.B.

²⁹Me pyetësorin standard në dosjen e Komisionit, si dhe në Aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁰Kontratë Huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2015; njoftim debitimi datë 3.9.2015, i “Raiffeisen Bank”; njoftim debitimi datë 4.9.2015, i “Raiffeisen Bank”; vërtetim datë 18.10.2016 nga subjekti “*****” sh.p.k.; ekstrakt historik të shoqërisë “*****” sh.p.k., e cila është regjistruar nga vitit 1997 me NIPT *****; vërtetim datë 20.1.2017 nga subjekti “*****” sh.p.k., i cili konfirmon se detyrimi që huamarrësi Niko Rapi ka ndaj këtij subjekti në shumën 4.000.000 lekë figuron i pasqyruar që nga data 3.9.2015, në pasqyrat financiare. Ky detyrim është i mbartur edhe në librat kontabël të vitit 2017 (referojuni Aneksit nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

³¹Referuar përgjigjes së pyetjes 19/c, si dhe dokumentacionit bashkëngjitur.

³²Ekstrakt të regjistrit tregtar për subjektin “*****” sh.p.k. me NIPT *****; Kontratë Huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2015, bashkëngjitur certifikatë regjistrimi e subjektit datë 6.10.2008, karta identiteti, dokumenti bankar 3.9.2015 për kalimin e shumës te huamarrësi; Kontratë Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.2.2019, bashkëngjitur: Prokurë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.2.2019, Certifikatë për vërtetim Pronësie, karta identiteti; dokumentin “nxjerrje llogarie” e llogarisë rrjedhëse/llogaria e pagës së bashkëshortit Niko Dh. Rapi printuar datë 24.10.2019, bashkëngjitur dokumenti për vërtetimin e numrit të kësaj llogarie; dokumenti “nxjerrje llogarie”, llogaria në “Raiffeisen Bank” të subjektit “*****” sh.p.k., datë 19.3.2019; Certifikate Familjare datë 1.2.2019 dhe Certifikatë Vdekjeje e shtetas L.R, datë 1.2.2019, të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Korçë; bilancin e shoqërisë për vitin 2015.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresë nr. *** prot., datë 21.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

5.2 Nga dosja e bashkëshortes së subjektit është administruar pyetëso³⁴, në të cilin është deklaruar marrëdhënia e subjektit me shtetasin L.B, ku shprehimisht është cituar se: “... kontrata e huas nr. 2137 rep., nr. 1175 kol., datë 3.9.2015 ka pasur si huamarrës bashkëshortin tim Niko Dh. Rapi. Marrëdhënia e tij me administratorin L.B është një marrëdhënie shoqërore/miqësore e ngushtë dhe e tillë është kjo marrëdhënie edhe me vëllezërit e tij (vëllezërit e Leonardit), shtetasit I.B dhe A.B. Dhe vëllezërit e bashkëshortit tim (R. dhe A.R) kanë gjithashtu marrëdhënie shoqërore e miqësore me shtetasin L.B”.

5.3 Njëkohësisht, nga dosja e bashkëshortes është administruar edhe informacioni³⁵ i ardhur nga Autoriteti i Prokurimit Publik, ku është konfirmuar se huadhënësi në cilësinë e administratorit të shoqërisë që administron, nuk ka nënshkruar kontrata me institucionin punëdhënës të bashkëshortit të subjektit.

5.4 Në Komision ka mbërritur një denoncim³⁶ i ri në datën 4.3.2020, nga një grup personash anonim, nga i cili ngrihen dyshime për situata të mundshme të konfliktit të interesit ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në të cilin denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit është në konflikt të pastër interesi me shtetasin L.B, administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., ku dhe ka marrë huan për blerjen e pasurisë. Në denoncimin e tyre bëjnë me dije se kjo shoqëri ka marrëveshje me shoqërinë “*****” dhe mbi këtë bazë, kërkojnë që Komisioni të hetojë nëse këto shoqëri kanë përfituar në procedurat e tenderimit për karburant në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në kohën kur subjekti ka qenë kryetar i kësaj gjykate. Gjithashtu, denoncuesit informojnë se subjekti ka udhëtuar jashtë vendit për të parë ndeshje sportive me persona me influencë dhe, për këtë, kërkojnë që të hetohet nga Komisioni.

5.5 Duke qenë se *indiciet* e paraqitura në denoncim lidhen me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe situata të mundshme të konfliktit të interesit, ky denoncim u shqyrtua në kuadër të vlerësimit të pasurisë, duke çmuar se veprimet dhe praktikat e dyshuara përmbajnë shkaqe për fillimin e hetimit kryesisht.

5.6 Komisioni ka pyetur³⁷ subjektin mbi pretendimet e denoncuesit, i cili në përgjigjen e dhënë, ndër të tjera, ka sqaruar se me shtetasin L.B dhe vëllezërit e tij ka marrëdhënie shoqërore dhe se në dijeninë e tij shoqëria “****” sh.p.k., merret përgjithësisht me aktivitet në fushën e ndërtimit, hotelerisë dhe karburanteve. Gjithashtu, ai ka sqaruar se nuk ka dijeni për karakterin e bashkëpunimit midis shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., por se te kjo e fundit shoqëria “****” sh.p.k. furnizohet me karburant. Më tej, subjekti ka deklaruar se megjithëse nuk shprehet i sigurt, në kohën që ka qenë drejtues në këtë gjykatë nuk ka pasur gjykime me këto shoqëri.

5.7 Subjekti ka deklaruar në shpjegimet e tij se ka udhëtuar me shtetasit L.B dhe K.M në Myhni, Gjermani, për të parë ndeshje futbollit në vitin 2011 dhe ka dalë nga pika kufitare Kapshticë me automjetin e shtetasit K. M (së bashku edhe me shtetasit A. M dhe A.Z) dhe, më tej, kanë marrë fluturimin Selanik - Mynih. Me shtetasin L.B janë takuar në Gjermani, pasi ai kishte udhëtuar dy ditë më parë. Subjekti ka deklaruar se ka qëndruar në hotel.

5.8 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2020, i është kërkuar informacion nëse nga subjekti janë zhvilluar procese gjyqësore me palë shoqëritë tregtare “****” apo “*****”, si dhe nëse janë zhvilluar procedura tenderimi me shoqërinë “*****” sh.a., gjatë periudhës që subjekti i rivlerësimit, z. Niko Rapi, ka qenë drejtues në këtë institucion, gjithashtu, Komisioni ka pasur edhe disa komunikime me e-mail me kryetarin e kësaj gjykate.

³⁴Referojuni pyetësorit datë 13.11.2019.

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 6.12.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁶Nr. *** prot., datë 4.3.2020.

³⁷Referojuni pyetësorit me e-mail datë 5.3.2020, në dosjen e Komisionit.

5.9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka informuar³⁸ se subjekti i rivlerësimit, për kohën që ka qenë gjyqtar në këtë gjykatë, nuk ka gjykuar çështje si gjyqtar i vetëm apo anëtar i trupit gjykues, ku subjektet “*****” sh.p.k. dhe “*****” sh.p.k. të kenë qenë palë ndërgjyqëse.

5.10 Në lidhje me procedurat e tenderimit me këto shoqëri, gjykata ka informuar se gjatë kohës që subjekti ka qenë kryetar, janë nënshkruar dy kontrata me shoqërinë “*****” sh.a., me objekt “furnizim me karburant”, përkatësisht në vitet 2014 dhe 2015, gjithashtu, gjykata³⁹ ka vënë në dispozicion kopjet e kontratave së bashku me dokumentet shoqëruese të procedurës tenderuese.

5.11 Nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se në procedurën tenderuese për vitin 2014, sipas raportit përmbledhës të prokurimit datë 20.2.2014, rezulton se ndër të ftuarit ekonomikë për të dhënë ofertat e tyre në procedurën e prokurimit për “blerje karburanti, kaldajë, automjet dhe gjenerator, me fondin limit 1.123, 541 lekë”, është renditur edhe shoqëria “*****” sh.p.k. Më tej, thuhet në raport “... nga vlerësimi i ofertave bazuar në kriteret e vendosura është vlerësuar shoqëria ‘*****’ sh.a.”.

5.12 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka informuar më tej, me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020 në lidhje me procedurat e tenderimit me këto shoqëri, për vitet 2012 – 2013, nga ku rezulton se janë nënshkruar dy kontrata: 1 me shoqërinë “*****” sh.p.k. për vitin 2012 dhe 1 me shoqërinë “*****” sh.a., për vitin 2013, me objekt “furnizim me karburant”. Gjykata ka vënë në dispozicion kopjet e kontratave së bashku me dokumentet shoqëruese të procedurës tenderuese.

5.13 Nga ky dokumentacion vihet re se edhe në procedurat e viteve 2012 dhe 2013, shoqëria “*****” sh.p.k. është ftuar të marrë pjesë në këto procedura prokurimi (si në vitet 2014 – 2015 më sipër).

5.14 Shoqëria fituese e prokurimit të kryer në vitin 2013 është “*****” sh.a., e cila para lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës fituese me titullarin e institucionit (subjektin e rivlerësimit), datë 28.3.2013, ka paraqitur edhe formularin e sigurimit të kontratës, i cili është bërë në emër të shoqërive “*****” sh.p.k. dhe “*****” sh.a. (duke paraqitur edhe NIPT-in përkatës të dy shoqërive). Në vijim, të gjitha kontratat e tjera, ndër vite, janë fituar nga shoqëria “*****” sh.a.

5.15 Nisur nga fakti i konstatuar se: (a) ndër të ftuarit ekonomikë është renditur edhe shoqëria “*****” sh.p.k., në raport me deklarinimin e subjektit se me shtetasin L.B dhe vëllezërit e tij ka marrëdhënie shoqërore dhe se në dijeninë e tij kjo shoqëri merret, përgjithësisht, me aktivitet në fushën e ndërtimit, hotelerisë dhe karburanteve; (b) nuk ka dijeni për karakterin e bashkëpunimit midis shoqërisë “*****” sh.p.k. dhe “*****” sh.p.k., por se te kjo e fundit, shoqëria “*****” sh.p.k. furnizohet me karburant; (c) tenderimi është finalizuar me fitues shoqërinë “*****” sh.p.k., por nga dokumentet duket sikur kanë pasur bashkëpunim që në vitin 2013; (d) ligji i aplikueshëm nr. 9367, datë 7.4.2005; nr. 9643, datë 20.11.2006; neni 3, pika 13/a dhe pika 20, neni 26/1/b, pika 2/c e shtojcës nr. 6, në procedurën e tenderimit, etj., duket se dijenia e palëve mbi ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë “*****” sh.p.k. ka qenë reciprokisht e njohur dhe, për pasojë, duket se subjekti i rivlerësimit në këtë procedurë tenderimi, gjendet në kushtet e konfliktit në dukje të interesit me shoqërinë “*****” sh.p.k., me administrator shtetasin L.B.

5.16 Komisioni ka pyetur⁴⁰ shoqërinë “*****” sh.a., nëse ka pasur kontrata bashkëpunimi në Pogradec me subjektin “*****” sh.p.k., apo nëse ka zhvilluar në bashkëpunim me këtë shoqëri, apo i vetëm ndonjë procedurë tenderimi apo ka lidhur kontrata me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

5.17 Shoqëria “*****”, në përgjigjen⁴¹ e dhënë, ka informuar se:

³⁸ Shkresë datë 30.4.2020.

³⁹ Shkresën e saj, datë 30.4.2020.

⁴⁰ Referojuni pyetësorit me e-mail, datë 29.4.2020, në dosjen e Komisionit, si edhe korrespondencës zyrtare.

⁴¹ Nr. *** prot., datë 11.5.2020.

- a) Ka kontrata bashkëpunimi me shoqërinë “*****” sh.p.k. në Pogradec dhe i ka kaluar asaj të drejtën e përdorimit të logos, me qëllim furnizimin e subjekteve, për të cilat është kontraktuar. Gjithashtu, kjo shoqëri informon se shoqëria “*****” sh.p.k. prej shumë vitesh, duke iu referuar vitit 2010, ka ekskluzivitetin dhe të drejtën e mbledhjes së tollonave me institucionet shtetërore të kërkuara shoqërisë “*****”, praktikë që ndiqet edhe sot me marrëveshje TIP.
- b) Ka hyrë e vetme në procedurat tenderuese dhe se, në asnjë rast, shoqëria “*****” sh.p.k. nuk ka qenë palë kontraktore me të.
- c) Procedura e furnizimit me karburant për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec vijon edhe aktualisht e fituar që prej vitit 2013 me procedurë tenderimi të përvitshme.

5.18 Komisioni, me shkresën⁴² nr. ***** prot., datë 11.6.2020, e ka pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec lidhur me dijeninë mbi marrëdhënien mes shoqërive “*****” sh.a dhe “*****” sh.p.k.

5.19 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec⁴³, në përgjigjen e saj, ka informuar Komisionin se *janë në dijeni që procedura e furnizimit me karburant do të bëhet pranë shoqërisë “*****” sh.p.k. sipas kushteve të kontratës dhe se furnizimi me karburant bëhet nga shoqëria “*****” sh.p.k. që nga viti 2012 dhe aktualisht.*

5.20 Në përfundim të hetimit kryesisht ka rezultuar se:

- a) Subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për aktivitetin e shoqërisë “*****” sh.p.k. në fushën e karburanteve. Referuar Kontratës së Prokurimit të vitit 2013 duket se shoqëritë “*****” sh.a dhe “*****” sh.p.k. kanë pasur bashkëpunim dhe duket se edhe subjekti ka qenë në dijeni. Po ashtu, nga të dhënat në rrjetet sociale duket se bashkëpunimi mes këtyre shoqërive është fakt i njohur publikisht.
- b) Nga informacioni i mbledhur nga shoqëria “*****” duket se aktiviteti i shoqërisë “*****” sh.p.k. në fushën e karburanteve është i njohur në Pogradec dhe i deklaruar. Gjithashtu, shoqëria “*****” sh.p.k. në mënyrë ekskluzive prej vitesh kryen shpërndarjen e karburantit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe jo vetëm, informacion ky, që konfirmohet edhe prej kësaj gjykate.

5.21 Pas vlerësimit të denoncimit të datës 4.3.2020 dhe dokumentacionit të administruar duket se *indiciet* kanë arritur një nivel të arsyeshëm besueshmërie për veprimin dhe praktikën e dyshuar, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, prandaj Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimi barrën e provës për të shpjeguar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

6. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar⁴⁴ se për shkak të gjendjes jo të mirë teknike të automjetit të tij, ka udhëtuar me automjete të rastit ose shërbim taksit dhe me automjete të marra me akt huapërdorje, ku njëra prej të cilave i përket shoqërisë “*****” sh.p.k., e cila nëpërmjet Prokurës së Posaçme datë 4.6.2016, nr. ***** rep., dhe nr. ***** kol., emëron si përfaqësues ligjor dhe të posaçëm z. Niko Rapi, të cilit i jep tagrat e përfaqësimit që të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë lidhur me përdorimin, blerjen, shitjen e automjetit tip “Land Rover”, me targa AA ***** , vetes dhe të tretëve, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për një afat të papërcaktuar.

6.1 Nga verifikimi në sistemin e AMF-së duket se ka pasur siguracion edhe në emër të përdoruesit për një periudhë 3 – 4-vjeçare.

6.2 Nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezulton se subjekti ka udhëtuar me këtë automjet i shoqëruar nga familjarët.

⁴² Nga informacioni që ne disponojmë ka rezultuar se shoqëria “*****” si fituese e disa tenderave në institucionin tuaj, e kryen shpërndarjen e karburantit nëpërmjet shoqërisë “*****” sh.p.k. mbështetur në një marrëveshje TIP. A dispononi ju këtë marrëveshje dhe a keni dijeni se kjo procedurë ndiqet nga shoqëria “*****” sh.p.k.?

⁴³ Shkresë nr. ***** prot., datë 16.6.2020.

⁴⁴ Referojuni pyetësorit standard të datës 22.12.2019.

6.3 Subjekti nuk e ka deklaruar zotërimin e këtij automjeti në DPV-në e vitit 2016.

6.4 Në përgjigjet e ardhura nga DPSHTRr-ja⁴⁵ rezulton se ky automjet është blerë nga shoqëria “*****” sh.p.k., (përfaqësuar nga shtetasi A.B) në vlerën 28.500 (njëzet e tetë mijë e pesëqind) euro dhe është regjistruar në datën 18.11.2011. Më tej, automjeti ka qenë i bllokuar nga tatim-taksat dhe rezulton i zhbllokuar në vitin 2016. Në dokumentin me nr. ***** prot., datë 16.8.2016, lidhur me zhbllokimin e disa automjeteve, ndër të cilat edhe ky automjet, emri i shtetasit L.B figuron subjekt për shoqërinë “*****” sh.p.k., por edhe për shoqërinë “*****”. Në vitin 2019 ky automjet i është shitur një shtetasi në Elbasan.

6.5 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur trajtime preferenciale/favorizuese nga shoqëria “*****” sh.p.k., të cilat duket se shkojnë përtej miqësisë, pikërisht, dhënia e huas nga kjo shoqëri, në shumën 40.000 (dyzet mijë) euro nga të ardhurat e shoqërisë tregtare dhe dhënia e automjetit në zotërim të subjektit apo kryerja e disa udhëtimeve të përbashkëta, duket se janë trajtime preferenciale të kryera, gjithashtu, në kushtet e konfliktit të interesit dhe të padeklaruaras si të tilla nga subjekti.

6.6 Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 3.1 parashikon se: “*‘Konflikt i interesit’ është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike*”. Kufizimet ligjore kanë për qëllim të garantojnë paanësinë dhe objektivitetin në ushtrimin e detyrave apo në kryerjen e procedurave administrative⁴⁶, të kufizojnë nepotizmin dhe korrupsionin. Pengesat ligjore të vendosura nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 apo Kodi i Procedurave Administrative synojnë të rregullojnë marrëdhënie të caktuara me palë në procedura administrative apo palë në procese gjyqësore, marrëdhëniet midis të cilave mund të ngrenë dyshime për respektimin ose jo të parimit të paanësisë ose të objektivitetit. Në vlerësim të pengesave ligjore të përcaktuara nuk është e nevojshme të provohet nëse veprimi apo pasoja ka ardhur, por mjafton vetëm “mundësia” e veprimit kundër parimit të paanësisë dhe të objektivitetit për të vënë në lëvizje detyrimin dhe pasojën juridike të moszbatimit të tij.

Nga sa vërehet duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë në “konflikt të vazhdueshëm interesi”, së paku në dukje, pasi gjendja në të cilën ndodhen për shkak të marrëdhënies së posaçme me shtetasin L.B dhe vëllezërit e tij duket se mund të krijonin konflikt interesi në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

6.7 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin mbi përdorimin e automjetit në DPV-në përkatëse dhe arsyen se pse shoqëria “*****” sh.p.k. duhet t’i japë në zotërim pa kushte automjetin, në pronësi të saj, subjektit të rivlerësimit, si dhe pse një shoqëri tregtare do të ishte e interesuar për t’i dhënë në përdorim afatgjatë dhe pa kundërshtim, një personi privat (individ) që s’ka asnjë lidhje me këtë shoqëri tregtare, pa llogaritur interesin.

6.8 Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të shpjeguar nëse fakti se një gjyqtar apo një kryetar gjykate, që merr një hua të konsiderueshme nga një shoqëri tregtare dhe zotëron një automjet të konsiderueshëm në kuptimin e gjerë të fjalës, në pronësi të së njëjtës shoqëri, duke qenë se në pozitën e drejtuesit të institucionit janë nënshkruar disa kontrata për furnizimin me karburant në favor të shoqërisë tregtare, e cila e kryente shpërndarjen nëpërmjet shoqërisë “*****” sh.p.k., që ka qenë pjesëmarrëse në procedura tenderuese të firmosura nga subjekti i rivlerësimit dhe, në një rast, ka qenë së bashku me shoqërinë “*****” sh. a. (viti 2013), përbën një konflikt interesash, së paku në dukje, siç parashikohet në dispozitën ligjore të sipërcituar.

⁴⁵ Shkresë nr. *****prot., datë 11.5.2020.

⁴⁶ Neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative.

6.9 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në udhëtimin e sipërcituar, çdolloj pagese është bërë (mbuluar) prej tij dhe se gjendja e likuiditeteve në vitin 2011 e mundësonte mbulimin e këtij shpenzimi, referuar edhe pasqyrës financiare të përpiluar nga Komisioni.

6.10 Në lidhje me automjetin me targa AA *****, në pronësi të shoqërisë “*****” sh.p.k., subjekti ka shpjeguar se e ka shfrytëzuar vetëm për një udhëtim disa orë për të lëvizur nga Pogradeci në Ohër, Maqedonia e Veriut, në qershor të vitit 2016, pavarësisht përmbajtjes së aktit të emërtuar prokurë dhe tagrave të përmendura në të. Pavarësisht formulimit të aktit noterial me përcaktime standarde lidhur me tagrat e dhëna apo lidhur me shtrirjen kohore të këtyre tagrave, qëllimi nuk ka qenë pajisja me të gjitha të drejtat e përmendura, por vetëm mbajtja e automjetit vetëm ditën e nënshkrimit të aktit noterial, datë 4.6.2016, jashtë vendit.

6.11 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: “... nuk kam pasur detyrimin që mbajtjen disa orë të këtij automjeti ta deklaroja në DPV-në e vitit 2016”. Subjekti ka vijuar me shpjegimin lidhur me dyshimet që ngrihen mbi një posedim absolut prej tij të këtij automjeti, duke referuar nenin 304 të Kodit Civil: “*Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi të*”. Referuar doktrinës juridike për posedimin si institut, ai paraqitet si një gjendje fakti që lidhet me kontrollin fizik mbi një send, aktivitet ky i shtrirë në kohë të arsyeshme, e shoqëruar me vullnetin dhe dëshirën për të ushtruar këtë kontroll fizik. Pikërisht, për shkak të posedimit të fituar nga dikush, të gjithë personat e tjerë konsiderohen të zhveshur nga posedimi dhe nga të drejtat reale të tij.

6.12 Subjekti shprehet se: “... duke e ballafaquar këtë koncept të posedimit me situatën në fjalë, arrij të provoj faktin se unë nuk kam ushtruar as kontrollin fizik dhe as të drejtat reale mbi automjetin në fjalë për t’u konsideruar ‘posedues’, pasi vetëm disa orë më vonë sendi i ka kaluar pronarëve të vërtetë, të cilët edhe gjatë këtij harku i kanë pasur të drejtat reale (të drejtat mbi sendin).

Nga posedimi duhet të dallojmë mbajtjen e thjeshtë të sendit. Për të qenë posedues është i nevojshëm shpirti ose qëllimi për të poseduar, qëllimi për t’u sjellë si pronar i sendit ose dhe në posedimin e të drejtave të tjera reale. Në këtë kontekst, ai që mban një send falë frymës së tolerancës apo besimit nga pronari, nuk konsiderohet posedues, por mbajtës i thjeshtë i sendit (kur merr mjetin e një familjari si vëllai, motra etj. dhe udhëton për një arsye pune brenda ditës (merr makinë me qira ditore, apo kur merr një libër për ta lexuar nga biblioteka e tjetrit). Legjislacioni civil bën dallimin ndërmjet ‘poseduesit’ dhe ‘mbajtësit’, përderisa në nenin 296 të Kodit Civil parashikohet: ‘Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues apo mbajtës’. Përveçse jo posedues absolut, vlerësoj se nuk kam qenë as në kushtet e trajtimit preferencial lidhur me përdorimin e këtij automjeti, pasi për t’u konsideruar i tillë, marrin vlerë elementë të tillë si koha dhe shpeshtësia e veprimit.”

Lidhur me situatat e mundshme të konfliktit të interesit subjekti ka shpjeguar se: “... në detyrën time si gjyqtar nuk e kam vendosur veten asnjëherë në rrethanën klasike se si mund të gjendet një gjyqtar në situatën e konfliktit të interesit, atë të zhvillimit të një procesi gjyqësor me palë, të cilat i ka të afërm, miq apo interesa të tjera që mund të diktojnë rrethana njëanshmërie sipas ligjit procedural, civil apo penal. Çështja e konfliktit të interesit që shtrohet lidhet me pozitën (cilësinë) e drejtuesit të gjykatës (në vështrimin administrativ emërimi kryetar e bën një ‘zyrtar’) në një tërësi rrethanash që e bënin të pashmangshme lidhjen e kontratës si veprim fundor e krejtësisht formal që bën drejtuesi.

*Shoqëria “*****” sh.p.k., në asnjë rast, nuk ka qenë palë kontraktore me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të drejtuar nga ana ime dhe, unë, si drejtues nuk kam qenë i ngarkuar me ligj të shoh e vlerësoj dokumentacionin e tenderimit që paraqesin palët dhe administrojnë njësitë e prokurimit. Në dokumentacionin final të nënshkrimit të kontratës dhe në dokumentacionin lidhur me kryerjen e pagesave, kjo shoqëri nuk ka figuruar në asnjë moment dhe në asnjë moment si drejtues nuk kam pasur interes personal. Në pozicionin e drejtuesit kam qenë ngushtësisht formal, sipas*

*parashikimit të ligjit, për të parë vetëm subjektin fitues me të cilin do të nënshkruaja kontratën përkatëse, konkretisht shoqërinë ‘****’, me të cilën për asnjë moment nuk kam pasur ndonjë situatë në kuptim të ligjit nr. 9367/2005, të ndryshuar.*

Në pozicionin e drejtuesit të gjykatës mendoj se nuk ndodhem në një situatë ‘konflikt në dukje i interesit’, pra, nuk ka pasur asnjë ndikim në asnjë fazë apo formë të procesit të furnizimit me karburant të institucionit, ky ndikim as nuk ka ndodhur dhe as kishte mundësi që të ndodhte.

Në vështrim të dispozitave të ligjit të posaçëm që rregullojnë situatën e konfliktit të interesit, qoftë edhe në dukje, mendoj se në rastin e subjektit të rivlerësimit, Niko Rapi, një situatë e tillë nuk ekziston dhe nuk duhet të merret si komponent në procesin e rivlerësimit.”

6.13 Në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave të rezultuara gjatë hetimit në raport edhe me shpjegimet e subjektit, si dhe në referencë edhe të praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, trupit gjykues çmon se tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregojnë një raport të tillë të përkujdesjes së subjektit me zbatimin e ligjit, i cili është i papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Rëndësia e sjelljes jashtëgjyqësore të gjyqtarit dhe ndikimi i saj në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare për sjelljen e gjyqtarëve, si: Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë⁴⁷, Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore⁴⁸ e të tjera akte ndërkombëtare, si dhe e jurisprudencës së GjEDNj-së⁴⁹, të cilat theksojnë se shkelja e ligjit nga një gjyqtar jo vetëm dëmton reputacionin e funksionit si gjyqtar, por inkurajon mosrespektimin e ligjit dhe cenon besimin e publikut në integritetin e gjyqësorit.

Këto rrethana marrin rëndësi edhe për faktin se subjekti ka qenë Kryetar i gjykatës për një periudhë të gjatë kohe, duke e ekspozuar atë posaçërisht në cenimin e besimit të publikut, në kushtet kur duhet të kujdesej që edhe sjellja e gjyqtarëve të tjerë të gjykatës që drejtonte, të ishte e denjë dhe të mos ngriheshin perceptime favorizimi apo përfitime për shkak të pozicionit, në sytë e publikut.

Në vlerësimin e trupit gjykues, këto rrethana, të sipërcituara, janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të germës “d”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

7. Lidhur me pasuritë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. M.M

7.1 Tokë bujqësore në fshatin ****, Njësia Administrative ****, Bashkia Shijak, referuar dokumentit “akti i marrjes së tokës në bujqësi me nr. *** regjistri, datë 9.8.1994, në emër të kryefamiljarit Sh.M”. Sipas këtij akti, familja është trajtuar me sip. 11.122 m² tokë gjithsej, ku nga kjo sip. prej 10.252 m² tokë bujqësore. Referuar dokumentit “certifikatë e përbërjes

familjare” datë 1.8.1991, në familje kanë qenë 5 anëtarë. Sipërfaqja e tokës bujqësore të përfiturar figuron e regjistruar në emër të kryefamiljarit, z. Sh.M.

7.1.1 Kjo pasuri është deklaruar nga bashkëshortja (veçmas si subjekt rivlerësimi) në deklaratën periodike të vitit 2003.

Sipas dokumentacionit të administruar rezulton se bashkëshortja e subjektit është trajtuar me tokë bujqësore, me sip. 2245 m², sipas ligjit nr. 7501, viti 1991, “Për tokën”. Sipas aktit nr. ****regj., datë 9.8.1994, të marrjes së tokës në pronësi, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka përfiturar tokë në pronësi sipas ligjit nr. 7501, viti 1991. Po sipas certifikatës së Zyrës së Gjendjes Civile

⁴⁷ Kodi i Etikës Gjyqësore 21, i miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në datën 8.12.2006, në rregullën 3 parashikon: “Gjyqtari nuk duhet të lejojë që familja, të afërmit e tij apo persona të tjerë të influencojnë në punën dhe vendimet e tij. Ai nuk duhet të cenojë prestigjin e detyrës gjyqësore për hir të interesave privatë dhe në të njëjtën kohë nuk duhet t’u krijojë të tjerëve përshtypjen se vepron në mënyrë të tillë”.

⁴⁸ Komentari i Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, në paragrafin 108, shpjegon: “[...] Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe të dëmtojë imazhin e gjyqtarit e të ngrejë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit në tërësi.”

⁴⁹ GjEDNj-ja, në çështjen Baka k. Hungarisë (Dhoma e Madhe 2016), është shprehur: “Gjykata në shumë raste ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit, i cili, si një garantues i drejtësisë, njehet nga vlerat themelore të shtetit të së drejtës, duhet të gëzojë besimin e publikut që të jetë i suksesshëm në kryerjen e detyrës së tij”.

**** rezulton se bashkëshortja e subjektit ka qenë në të njëjtin trung familjar në datën 1.8.1991, si një ndër kërkesat e këtij ligji për të qenë pjesë përfituese e kësaj pasurie, në analizë të dokumentacionit të administruar në raport me kërkesat e ligjit të cituar.

7.1.2 Nga hetimi rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë pasuri.

7.2 Llogari page nr. ***, në “Union Bank”.** Gjendja e llogarisë datë 20.1.2017 rezulton në shumën 91 lekë, nga dokumenti “nxjerrje llogarie” e printuar në po këtë datë. Pjesa takuese: 100 %. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar⁵⁰ dy nxjerrje llogarie.

7.2.1 Nga korrespondenca me “Union Bank”⁵¹ konfirmohet gjendja e llogarisë sipas deklaramit të subjektit.

8. Subjekti deklaron në DPV-të e viteve 2004 – 2007 si adresë banimi: Rr. “*****” Korçë (pallatet e reja), lagjja nr. ***, ndërsa regjistrimi si banor rezulton në Njësinë Administrative Nr. ***, Tiranë.

8.1 Në pyetësin datë 21.10.2019, të administruar nga bashkëshortja e subjektit, është shpjeguar se kjo adresë përkon me adresën: Rr. “*****”, nr. ****, aktualisht, në sistemin e ri të adresave: Rr. “*****”, Blloku i Ri, banesa nr. ****, Korçë, e cila i përket shtetasit R.S.R, djali i xhaxhait të subjektit. Bashkëshortja deklaron se nuk kanë banuar në këtë adresë edhe pse është lidhur Kontrata e Qirasë nr. **** rep., nr. **** kol., datë 17.8.2000, ndërmjet babait të subjektit, Dh.R (qiramarrës) dhe shtetasit R.R (qiradhënës), por banesa në të cilën kanë banuar ka qenë me adresë: Rr. “*****”, lagjja ***, h. ***, p. ***, Korçë, e marrë me qira te shtetasi I.H.J me Kontratë nr. **** rep., **** kol., datë 30.10.2002.

8.2 Subjekti deklaron në DPV-të e viteve 2012 – 2014 si adresë banimi: Njësia nr. ***, Rr. “*****”, Tiranë. Ndërkohë, bashkëshortja shpjegon në pyetësin e datës 21.10.2019 se kjo banesë përkon me vendbanimin e vëllait të subjektit, z. A.R. Për këtë është lidhur edhe Kontrata e Huapërdorjes nr. **** rep., dhe nr. **** kol., datë 23.11.2012, ndërmjet subjektit Niko Rapi dhe z. A.R (banesa në kontratë përshkruhet si pasuri me nr. *****, e ndodhur në Rr. “*****”, Njësia Bashkiake nr. ***)).

8.3 Ndërkohë në pyetësorët e administruar nga dosja e bashkëshortes dhe shpjegimet e mëvonshme, gjatë hetimit të Komisionit, është deklaruar si banesë adresa: Rr. “*****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Korçë, e cila përkon me adresën e apartamentit të blerë nga subjekti gjatë vitit 2007.

8.4 Subjekti i rivlerësimit është pyetur për këtë, i cili ka deklaruar se dy kontratat noteriale si qiramarrës, janë kryer për t’u regjistruar si banor në zyrat e gjendjes civile përkatëse, si dhe këto apartamente nuk janë përdorur asnjëherë për banim prej tij dhe familjes.

8.5 Gjatë hetimit duket se subjekti ka banuar edhe në Tiranë (në vitet 2010 – 2015) si ekspert i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës).

8.6 Lidhur me këto konstatime të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se: “...nuk kam banuar në banesat e regjistruara në emër të vëllait tim A.R dhe të djalit të xhaxhait tim, R.R. Sqaroj se që nga fillimi i detyrës në tetor të vitit 2001 kam banuar në qytetin e Korçës, në një banesë të marrë me qira (lagjja nr. ***, Rr. ‘*****’, pallati nr. ***, hyrja ***, Korçë e marrë me qira te shtetasi I.H.J me kontratë nr. **** rep., **** kol., datë 30.10.2002) për t’u zhvendosur në qershor të vitit 2007 në banesën e blerë në qytetin e Korçës sipas aktmarrëveshjes së porosisë datë 15.2.2007 dhe Kontratës së Shitblerjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 3.9.2008.

⁵⁰Nxjerrje llogarie nga “Union Bank” në emër të shtetas M.M., me nr. *****, për periudhën 1.1.2009 – 13.10.2016; nxjerrje llogarie nga “Union Bank” në emër të shtetas M.M., me nr. *****, për periudhën 1.1.2015 – 20.1.2017, me balancë në datën 20.1.2017, në shumën 91 lekë (referojuni Aneksit nr.***, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵¹Shkresë nr. ***** prot., datë 3.2.2020.

*Banesat e përshkruara në kontratat e qirasë nuk kanë shërbyer për të jetuar në Tiranë, pasi jetesa ka vijuar në qytetin e Korçës, së bashku me familjen (përfshirë dhe dy prindërit), për t'u zhvendosur në gusht të vitit 2015 në banesën e blerë në Tiranë, ku edhe jetoj aktualisht (Kontrata e Shitblerjes nr. ***rep., nr. ***kol., datë 4.9.2015).*

Për sa i përket faktit që kam qenë edhe ekspert i Shkollës së Magjistraturës, sqaroj se kam qenë ekspert i jashtëm dhe maksimalisht numri i ditëve të seminarit ka qenë dy, ndërsa mund të jetë përsëritur seminari dy ose tri herë në vit.”

9. Referuar të dhënave nga sistemi *TIMS* rezulton se subjekti ka udhëtuar në pikat më të afërta të kufirit me automjete që kanë qenë në pronësi të shtetasve të tjerë edhe pse vetë ka pasur në zotërim automjet personal (targa TR ***** ose AA *****) dhe për një periudhë kohore gjatë së cilës ka qenë në funksionin e kryetarit të gjykatës në Pogradec (periudha 22.4.2008 – 11.10.2015) ka pasur në përdorim edhe automjetin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (targa PG *****).

9.1 Gjatë hetimit të Komisionit është vënë re se subjekti ka udhëtuar me automjete të shtetasve të tjerë, vetëm apo i shoqëruar prej tyre.

9.2 Subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka deklaruar⁵² se për shkak të gjendjes jo të mirë teknike të automjetit të tij ka udhëtuar me automjete të rastit ose shërbim taksi dhe me automjete të marra me akt huapërdorje, disa prej të cilave i ka përcjellë, si vijon:

a) Prokurë e Posaçme nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 4.6.2016, nga shoqëria “*****” sh.p.k., të sipërtrajtuar në vendim;

b) Autorizim për huapërdorje nr. *** rep., datë 27.2.2010, me huadhënës G.C dhe huapërdorës Niko Rapi të automjetit tip “Volvo”, me targa PG *****, me afat 10-ditor. Gjithashtu, po këtë automjet ia jep përsëri huamarrësit Niko Rapi nëpërmjet Kontratës së Huapërdorjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 1.8.2011, për një periudhë 1-vjeçare;

c) Autorizim për huapërdorje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.8.2010, me huadhënës B.C dhe huapërdorës Niko Rapi të automjetit tip “KIA”, me targa PG *****, me afat 1-vjeçar;

ç) nga sistemi *TIMS* dhe deklarimet e subjektit rezulton se ai udhëton edhe me shtetasin A.Z – avokat në “*****”, në Pogradec dhe me shtetasin K.M – biznesmen dhe aksioner te shoqëritë “*****” sh.p.k., NIPT ***** dhe *** sh.p.k., NIPT *****, të dyja me aktivitet kryesor tregtimin e hidrokarbureve.

9.3 Në vijim, Komisioni ka kërkuar informacion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec⁵³ lidhur me çështje gjyqësore të trajtuara nga z. Niko Rapi gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar, me palë ndërgjyqëse shoqëritë: ****sh.a., “*****” sh.p.k., apo me shtetasin K.M dhe A.Z.

9.4 Përgjigjja e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka informuar se janë 95 vendime gjyqësore me gjyqtarin Niko Rapi dhe avokat z. A.Z, gjatë periudhës 2003 – 2016 dhe se pas verifikimit nuk kanë rezultuar të dhëna për procese gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqëritë: *** sh. a., “*****” sh.p.k., apo me shtetasin K.M.

9.5 Në përfundim të hetimit kryesisht, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e arritura nga hetimi administrativ i kryer.

9.6 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “... qëllimi i marrjes së mjeteve në përdorim ka qenë vetëm nevoja për të lëvizur brenda ditës në shtetin kufitar, Maqedonia e Veriut, dhe automjetet në fjalë janë përdorur vetëm brenda ditës dhe maksimumi deri të nesërmen (duke qëndruar në Ohër-Maqedoni vetëm një natë). Pavarësisht se aktet noteriale (autorizim përdorimi) të përmendura prej jush rezultojnë me afat përdorimi më të gjatë se një ose dy ditë, gjendja e faktit është e tillë, pra, janë përdorur vetëm për këto udhëtime njëditore, për t’iu kthyer pronarit qoftë atë natë, qoftë të nesërmen. Lidhur me çështjet gjyqësore të gjykuara me avokatin A. Z., ndër vite, vlerësoj t’ju

⁵² Referojuni pyetësorit standard të datës 22.12.2019.

⁵³ Shkresa nr. ***prot., datë 11.6.2020.

bëj prezent se në vendimet gjyqësore, ku pala është mbrojtur apo përfaqësuar nga ky avokat apo përfaqësues të studios së tij ligjore, nuk është privilegjuar, por është mbajtur i njëjti standard gjykimi nga unë si gjyqtar, sikurse edhe në të gjitha çështjet e tjera⁵⁴. Duke parë të gjitha çështjet në tërësi, është e qartë se asnjë vendimmarrje nuk lë vend për të menduar ndonjë ndihmë/avantazh/trajtim më pozitiv për shkak të zgjedhjes si mbrojtës të av. A. Z. ose avokatët e tjerë të studios së tij ligjore.”

9.7 Komisioni, në analizë të fakteve të mësipërme, arrin në konkluzionin se marrëdhënia personale dhe miqësore e subjektit të rivlerësimit me shtetasin A. Z., duhet të ishte e kufizuar në respektim të ushtrimit të detyrës së tij, pasi fakti se ushtronte funksionin e avokatit dhe se shpesh mund të përballëshin në procese gjyqësore, mund të krijonte një perceptim të gabuar te publiku dhe qytetarët e Pogradecit. Këtu mund të përmendim një ndër Parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarit, pikën 4.9 që parashikon: *“Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo të cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit për interesa private të tij apo të një anëtarit të familjes së tij, apo të kujt do tjetër, dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”*. Situatë ligjore dhe faktike kjo, parë në vlerësimin tërësor, në zbatim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dhe në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, që çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut.

9.8 Në vlerësimin e trupit gjykues, këto rrethana, të sipërcituara, janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, që përbën një shkak të veçar shkakimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në pikën 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

10. Në analizën financiare të viteve 2003 – 2016 ka rezultuar se e vetmja balancë negative është ajo në vlerën 405.550 (katërqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë në vitin 2007, të sipërtrajtuar në vendim, si dhe pamundësia reale financiare e babait të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhënien e huas në vitin 2008.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Komisioni, vlerëson se pamjaftueshmëria financiare e subjektit dhe pasaktësia në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2007, si dhe pamundësia e tij për të provuar realisht mundësitë financiare të babait të tij, për të mbuluar me burime të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhënien e huas në vitin 2008, në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për kualifikimin e tyre si mangësi në kuptim të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në vlerësim të rrethanave të sipërcituara në vendim, lidhur me konfliktin në dukje të interesit, Komisioni i çmon ato të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe se ai ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, të cilat përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të germës “d”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikat 3 e 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

18. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar⁵⁵ raportin mbi kontrollin e figurës, me nr. **** prot., datë 2.11.2017, si

⁵⁴ Shihni përgjigjet e rezultateve të hetimit për detaje konkrete.

⁵⁵Me shkresën nr. **** prot., datë 2.3.2020, e administruar në dosjen e Komisionit.

dhe raportin e rishikuar nr. ****⁵⁶ prot., datë 17.2.2020 për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 28.2.2020.

18.1 Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

18.2 Grupi i Punës i DSIK-së ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Niko Rapi.

18.3 Komisioni ka kërkuar nga organet kompetente rifreskim të informacionit apo të dhëna të reja lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga të cilat nuk kanë rezultuar të ketë indicje për hetime të mëtejshme lidhur me këtë subjekt rivlerësimi.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni nuk ka pasur të dhëna apo *indicie* nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo veprimtari korruptive të tij.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

19. Komisioni ka administruar raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, ka kryer hetime të plota lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tij si gjyqtar, si dhe ka vlerësuar denoncimet e ardhura për të.

20. Nga vlerësimi i tyre ka rezultuar se gjyqtari Niko Rapi ka njohuri në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai zbaton kërkesat e përgjithshme procedurale civile dhe penale dhe, kur është rasti, zbaton procedurën penale të gjykimit të posaçëm sipas rregullave të gjykimit të shkurtuar, etj.

21. Gjyqtari, në vendimet e hartuara, përdor literaturë të ndryshme juridike (libra, artikuj, botime, leksione, referate, etj.), si dhe parimet e përgjithshme në fushën e së drejtës civile dhe të drejtës penale. Gjithashtu, gjyqtari ka përdorur referenca në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë apo praktikës gjyqësore të po kësaj gjykate.

22. Gjyqtari Niko Rapi ka plotësuar standardin minimal të pjesëmarrjes, 28 ditë në 3 vjet, në formimin vazhdues, sipas pikës 5, të nenit 76, të Ligjit për Statusin. Lënda e trajnimeve, ku ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit në fushën penale dhe civile.

23. Në pesë dosjet e verifikuara ka rezultuar se në tërësi ato nuk janë ankimuar, por nisur nga analiza e vendimmarrjes së çështjes gjyqësore e cituar si dosja nr. ***, Komisioni pa cenuar dhe zëvendësuar logjikën e përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe pa prekur themelin e çështjes, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime duke u përqendruar kryesisht te vlerësimi i parimit të proporcionalitetit në gjykimin e kësaj çështjeje penale, në balancë me analizën e bërë lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe autorit të saj (rrethanat lehtësuese dhe pasqyrimet në vendimet nr.19/2011 dhe nr. 47/2012, të Gjykatës Kushtetuese).

23.1. Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar:

“... në lidhje me këtë gjetje dua të theksoj se në një vështrim më të gjerë sesa kjo çështje, edhe në raste të tjera të ngjashme (po kjo vepër penale), nga ana ime si gjyqtar është caktuar një masë dënimi e njëjtë apo e përafërt, apo edhe aplikimi i alternativave të dënimit, pra, është ndjekur një politikë penale e caktuar, kjo duke ruajtur një balancë midis rrezikshmërisë së veprës e të autorit, në raport me rrethanat lehtësuese në favor të tij, pa dëmtuar dhënien e drejtësisë. Është mbajtur parasysh në çdo rast identifikimi e vlerësimi, nëse jemi apo jo para një personaliteti me tendenca

⁵⁶Referojuni shkresës nr. **** prot., datë 6.2.2020 me të cilën Komisioni ka kërkuar rishikimin e raportit.

të theksuara për shkeljen e ligjit, për të respektuar të gjitha parimet e ligjit penal material, jo vetëm të parimit të proporcionalitetit, por edhe të parimit të humanizmit në dhënien e drejtësisë, duke caktuar një masë dënimi që nuk do ta pengonte gjatë të pandehurin në rifillimin e jetës normale, nisur edhe nga lloji i veprës dhe masa e dënimit që parashikon ligji për këtë veprë, apo edhe nga kërkesa e organit të akuzës, të cilat janë pothuajse në të njëjtën linjë. Në këtë drejtim, mund të përmend disa vendime, ku nga ana e prokurorisë është kërkuar po kjo masë dënimi (30 ditë burgim, me gjykim të shkurtuar 20 ditë burgim), si dhe aplikimi i alternativave të dënimit me burgim dhe po kështu është disponuar edhe nga gjykata, d.m.th. subjekti i rivlerësimit. Konkretisht, mund të përmend disa vendime: vendimi nr. ****, datë 24.6.2014, i pandehur F. K.; vendimi nr. ****, datë 18.9.2014, i pandehur L. A.; vendimi nr. ****, datë 15.9.2016, i pandehur B. P.; vendimi nr. ****, datë 16.9.2016, i pandehur G. I.; vendimi nr. ****, datë 4.4.2014, i pandehur A. A. etj.

Për sa shtrohet në kërkesën për shpjegime, mendoj se mund të mos aplikohet dhënia e një mase dënimi të ashpër, kur nga kjo veprë joformale nuk kanë ndodhur veprime të tjera të dënueshme me pasoja në shëndetin e jetën e njerëzve (d.m.th., kur nuk është shoqëruar edhe me kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale të po kësaj fushe, siç është 'Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor', apo 'Largimi nga vendi i aksidentit, përkatësisht nenet 290, 273 të Kodit Penal). Natyrisht, kjo vlerësohet edhe në lidhje me ekzistencën e rrethanave lehtësuese (sipas llojit e numrit të tyre, qoftë edhe vetëm pendimi i thellë, sipas nenit 48/pika 'ç', të Kodit Penal), apo edhe me rrethana të tjera në favor të të pandehurit në vështrim të nenit 49 të po këtij Kodi (të çmuara nga vetë gjykata, si p.sh. rrethanat familjare, qenia në proces arsimimi, ekzistenca e rrethanave të posaçme si probleme shëndetësore etj.). Të gjitha këto, në raport me llojin e veprës dhe masën e dënimit që parashikon dispozita e posaçme, mendoj se përbëjnë respektim të parimit të proporcionalitetit, përmendur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese."

24. Komisioni i ka kërkuar⁵⁷ KLGJ-së informacion për kontrollin e ushtruar ndaj subjektit, lidhur me kërkesa të adresuara për procedim disiplinor apo propozime për masë disiplinore nga organi kompetent.

24.1 KLGJ-ja ka informuar se ndaj subjektit nuk rezultojnë të dhëna mbi procedime disiplinore apo të jetë adresuar një kërkesë e tillë nga ministri i Drejtësisë dhe as ndonjë vendimmarrje nga ky institucion.

25. Në Komision janë paraqitur 11 denoncime për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Denoncimet, për të cilat janë konstatuar *indicie*, janë kryer hetime të plota duke kërkuar dosjet gjyqësore, si dhe shpjegime të detajuara prej subjektit⁵⁸.

26. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar denoncimin e shtetasit A. M., me cilësinë e palës së paditur në procesin gjyqësor që i përket vendimit të subjektit, pasqyruar si dokumenti nr. 3 në tri dosjet e përzgjedhura prej tij. Denoncuesi, mbi vendimmarrjen e subjektit, ka depozituar edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe ka paraqitur pretendimet e tij. Denoncuesi sqaron se, megjithëse procesi ka nisur kundër shtetasit T.M me cilësinë e autorit të veprës, në momentin që ai ka ndërruar jetë, është zëvendësuar me trashëgimtarët ligjorë dhe për pasojë detyrimet për dëmin e shkaktuar në vlerë monetare, si dhe për të bërë përgënjeshtimin e librit, në favor të palës paditëse, i janë atribuar trashëgimtarëve (denoncuesit dhe dy trashëgimtarëve të tjerë).

26.1 Denoncuesi ka informuar se vendimi është ndryshuar nga gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 17.01.2017, e cila ka vendosur detyrimin e trashëgimtarëve të autorit të tërheqin të gjithë kopjet e librit, si dhe të ndalojnë shpërndarjen e tij, ndërsa kanë rrëzuar pjesën tjetër të dispozitivit, mbi detyrimin pasuror dhe përgënjeshtimin publik. Ai nën këto argumente denoncon

⁵⁷Me shkresën nr. **** prot., datë 29.1.2020.

⁵⁸ Për më shumë referojuni dokumentit të rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit.

subjektin e rivlerësimit për shkelje të etikës profesionale por njëkohësisht edhe zvarritje të procesit gjyqësor, pasi ka zgjatur atë për më shumë se dy vite.

26.2 Për sa më sipër nga hetimi duket se me veprimet dhe rolin aktiv subjekti i rivlerësimit ka transferuar shpërblimin e dëmit tek personat e tretë që nuk janë subjekt i shkakimit të tij. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë, ku është bazuar për të legjitimuar dhe bërë zëvendësimin e palës së paditur, në raport me dispozitat ligjore të cituara më sipër dhe jo vetëm, si dhe mbi arsyetimin ligjor të bërë në vendimarrjen e Gjykatës së Apelit Korçë. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime edhe lidhur me pretendimet e denoncuesit për zvarritjen e procesit gjyqësor.

27. Në një vlerësim të përgjithshëm të denoncimeve dhe të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me to, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqësorëve të gabuara prej tij, e cila mund të çonte në një mungesë të aftësive profesionale.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga vlerësimi tërësor i çështjes, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar, të drejtën e pretenduar dhe qëllimin që synohet të arrihet, të gërshetuara me njëra-tjetrën, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në këtë logjikë, në faktet dhe në provat e referuara në vendim, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në germën “d”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikat 3 e 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Komisionit,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, z. Niko Rapi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.7.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini